



Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik "

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Fatmira Prodani kryetare, personel akademik DTI
2. PHD Candidate Krisel Tola anëtar, personel akademik ShK
3. MSC Oltiana Tashkollari anëtar, personel akademik ShK
4. Phd.Spiro Paço anëtar, Kordinator Institucional
5. Oriola Domi anëtare, Kordinatore për sigurimin e cilësisë
6. Lusian Koçi Student

Mars/Viti 2023

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Përshkrim përmbledhës; 200 fjalë

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është themeluar në vitin 2006 me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës” dhe ofron programin e studimit 2 vjeçar në “Aplikacion ne web dhe Dizenjim Grafik”. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike që është një nga tre njësitë bazë përbërëse të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. FTI është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.685, datë 25.08.2010.

Programi profesional 2- vjeçar është një program studimi bashkëkohor dhe shumë i kërkuar që synon të formojë dhe të pregatisë specialistë të aftë në fushën e dizenjimit & krijimit të faqeve web dhe dizenjimit grafik. Qëllimi kryesor i këtij programi është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dijet me anë të mësimdhënies dhe praktikave në laborator. Ky program studimi është projektuar duke menduar për të rinjtë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe dëshirojnë të përftojnë një profesion bashkëkohor duke ju bashkuar në një kohë më të shkurtër tregut të punës. Synimi i programit të studimit është ofrimi i elementëve dhe mjeteve të nevojshme për zhvillimin e aftësive në këto dy fusha kaq të kërkuara në tregun e sotëm. Nëpërmjet kurrikulave bashkëkohore, metodave, teknikave dhe instrumentëve inovativ, stafi i lektorëve të Departamentit të Shkencave Kompjuterike i specializuar në universite brenda dhe jashtë vendit synon të pregatisë specialistë të përshtatshëm për tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të brendshëm;

200 fjalë

Procesi i akreditimit të programit të studimit Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik ka filluar me ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm (GVB) për përgatitjen e dokumentacionit për akreditimin e këtij programi me urdhër të dekanatit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit datë 20.01.2023. (Evidenca nr 12)

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga 6 anëtarë, ku njëri është kryetar dhe 5 të tjerët janë anëtarë. Në GVB është përfshirë edhe një përfaqësues i biznesit në fushë e TI (që operon si ISP) dhe një përfaqësues i studentëve që ndjek programin e studimit, i cili është në proces akreditimi. Çdo anëtar i grupit të vlerësimit të brendshëm është përzgjedhur bazuar në trasparencën, besueshmërinë dhe profesionalizmin që kanë në fushën e aplikimeve Web dhe Dizenjimit Grafik.

Grupi i vlerësimit të brendshëm është i përbërë si më poshtë:

1. Dr. Fatmira Prodani kryetare, personel akademik DTI
2. PHD Candidate Krisel Tola anëtar, personel akademik ShK
3. MSC Oltiana Tashkollari anëtar, personel akademik ShK
4. Phd.Spiro Paço anëtar, Kordinator Institucional
5. Oriola Domi anëtare, Kordinatore për sigurimin e cilësisë
6. Lusian Koçi Student

SHKURTIME:

FTI	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
UAMD	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
DTI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
DSHK	Departamenti i Shkencave Kompjuterike
NJBSC	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë
AWDG	Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik

A series of handwritten signatures in blue ink, including a large stylized signature on the left and several smaller ones on the right.

**Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Aplikacion ne Web dhe
“Dizenjim Grafik”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
ME KARAKTER PROFESIONAL**

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit profesional-2 vjeçar “Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik” është në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) ¹ si dhe në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së FTI ² dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike (DSHK).
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Ky program studimi formon specialistë dhe profesionistë në fushën e “Aplikimit ne Web dhe Dizenjimit Grafik” duke ofruar një program studimi që i aftëson studentët për një nga profesionet më të kërkuara nga tregu i punës dhe me një perspektivë në rritje për të ardhmen. Programi i studimit profesional-2 vjeçar “Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik” është një nga programet e studimit me numrin më të madh të aplikanteve në FTI.
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	FTI dhe DSHK plotësojnë kriteret ligjore në lidhje me numrin e personelit akademik si dhe të titujve/gradave shkencore. Vlen të theksohet se ky fakultet është hapur në vitin 2010 dhe ka krijuar tashmë një qëndrueshmëri akademike si në numrin e personelit akademik me tituj / grada shkencore por edhe në profilizimin e tyre në kurset përkatëse duke siguruar edhe një cilësi të lartë në mësimdhënie. Personeli akademik i aktivizuar është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike. ³ Më konkretisht: - 55% e kurseve mbulohen nga personeli akademik i DSHK që i kanë mbuluar këto kurse në vazhdimësi ndër vite - 30% e kurseve mbulohen nga personeli akademik i njësisë të tjera bazë të FTI (Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI) dhe Departamenti i Matematikës (DM)) që i kanë mbuluar këto kurse në vazhdimësi ndër vite - 15% e ngarkesës mbulohen nga personel akademik i njësisë të tjera kryesore në UAMD
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Përfshirja dhe përvoja praktike gjatë edukimit po tregohet gjithnjë më e suksesshme se arsimiti i përgjithshëm në promovimin e karrierës së të rinjve. Kanë qenë kërkesat e studiove grafike dhe kompanive të reklamave për të rekrutuar studentët me aftësi programimi në web dhe dizenjimi grafik në kohëzgjatje më të shkurtër të studimeve për të qenë më herët në kontakt me tregun e punës meqenëse shumica e këtyre studentëve kombinojnë punën dhe edukimin.
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimit në diplomim dhe pas	

¹ Evidenca 2. Statuti i UAMD neni 3 dhe 3

² Evidenca 6. Rregullorja e FTI neni 1

³ Evidenca 15. Tabelë për personelin akademik për këtë program studimi

daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Vetëpunësimi gjithashtu është një nga mundësitë që specialistët në fushën e Programimit në Web & Dizenjimit Grafik mund ta shfrytëzojnë më së shumti kohët e fundit. Kjo mënyrë punësimi nënkupton se vetë specialisti ofrohet për të qënë zhvillues apo mirëmbajtës i projekteve drejtpërdrejt me kompaninë që e kërkon këtë shërbim. Janë të shumta platformat online që e ofrojnë mundësinë e kontaktit me projekte dhe kompani të ndryshme jashtë. Ky lloj punësimi njihet si “freelancer” dhe një numër i madh profesionistësh e shfrytëzojnë si punë primare ose si një mundësi për të punuar me kohë të pjesshme.			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimin të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Të gjitha programet e ofruara nga FTI përmbajnë kurse që mbulohen nga të tre departamentet e këtij fakulteti dhe kjo është karakteristikë edhe e programit profesional-2 vjeçar “Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik”. Pasi FTI harton orarin mësimor për programin profesional-2 vjeçar “Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik” në koordinim me njësitë bazë të tij, ky orar i dërgohet njësisve bazë për të përcaktuar personelin akademik që do mbulojë kurset përkatëse. Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin me korrektësi të detyrave gjatë zhvillimit të mësimin në kursin që mbulon. Ndarjet e përgjegjësive janë të mirëpërcaktuara në statutin e UAMD, në rregulloren e UAMD si dhe në rregulloren e FTI. ⁴
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënësit vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor, zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale etj., FTI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere, me biznese të fushës si dhe ka aplikuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që ofrojnë fonde për realizimin e objektivave të mësipërme. ⁵ Këto marrëveshje përfshijnë edhe pjesën e praktikës mësimore dhe profesionale si në ambjentet e FTI ashtu edhe për praktikat profesionale pranë bizneseve partnere, investimet në infrastrukturë, trajnimin e studentëve dhe personelit akademik, shkëmbimin e studentëve dhe njohjen e krediteve për periudhat e shkëmbimit etj. Për shkak të natyrës së këtij programi studimi dhe të kurseve që përmban,
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton rapo ⁶ rte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të	

⁴ Evidenca 4. Rregullore e UAMD, neni 25 pika 8D, neni 27, pika 3b

⁵ Evidenca 13. Lista e Marrveshjeve Institucionale

realizimit të programeve të studimeve.	praktikat mësimore zhvillohen kryesisht në ambjentet e FTI falë dhe investimeve në infrastrukturë që ky fakultet ka bërë për këtë qëllim.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Aktualisht FTI zotëron 6 laboratorë profesional si më poshtë: - 3 laborator kompjuterik për zhvillimin e praktikave mësimore për programim - 1 laborator kompjuterik për zhvillimin e praktikave mësimore për dizenjimin grafik - 2 laboratorë profesional për zhvillimin e praktikave profesionale, për zhvillimin e projekteve dhe punimit të diplomës. 3 laboratorët për praktikat mësimore (Sallat 101, 111 dhe 211) kanë 70 njësi pune në total dhe janë një investim që FTI ka përfunduar falë bashkëpunimit me kompani private (Crystal System Group). Laboratori për praktikat mësimore për dizenjimin grafik (salla 203) ka 20 njësi pune dhe është ndërtuar nga pjesëmarrja e FTI në projekte ndërkombëtare Erasmus Plus. Falë këtyre projekteve është ndërtuar edhe laboratori për zhvillimin e praktikave profesionale në fushën e multimedias (salla 103). Gjithashtu FTI ka ndërtuar në fillim të 2020 dhe një laborator kërkimor për zhvillimin e praktikave profesionale si pjesë e projekteve të AKSHI me 20 njësi pune (salla 015).			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Marrëveshje përfshijnë edhe pjesën e praktikës mësimore dhe profesionale si në ambjentet e FTI ashtu edhe për praktikat profesionale pranë bizneseve partnere, investimet në infrastrukturë, trajnimin e studentëve dhe personelit akademik, shkëmbimin e studentëve dhe njohjen e krediteve për periudhat e shkëmbimit etj. Këto marrëveshje janë mundësi shumë e mire punësimi për studentët.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit profesional-2 vjeçar “Aplikacion në Web dhe Dizajn Grafik” ofrohet si program studimi me kohë të plotë të organizuar me 120 kredite ECTS dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. ⁷ Ndarja e lëndëve në kurrikul është organizuar duke u bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018 për “elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Për të kompletuar elementët që përbëjnë strukturën e programit 2 -vjeçar profesional, Aplikacion ne Web dhe Dizenim Grafik në dokumentacionin shoqërues gjeni edhe programin lëndor dhe formatin e miratuar të suplementit.

⁷ Evidenca 14. Ligji nr 80/2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” neni 72, pika 1 dhe 2

<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Kurset e ofruara në programin e studimit 2 vjeçar Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik kategorizohen sipas kërkesave ligjore në kurse të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese.⁸</p> <p>Gjatë vitit të parë studentët zhvillojnë lëndët e formimit bazë (i përgjithshëm, lëndë profesionale (karakterizuese), lëndë ndërdisiplinore (me zgjedhje) dhe lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, praktika profesionale).</p> <p>Gjatë vitit të dytë studentët zhvillojnë lëndët e formimit profesional në fushën aplikacionit web dhe dizenjimit grafik</p> <p>Shpërndarja e kurseve midis semestrave dhe viteve akademike është e organizuar bazuar në shkallën e vështirësisë së tyre dhe ndërlidhjes midis kurseve dhe kërkesave të tyre profesionale.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit profesional-2 vjeçar “Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik” ofrohet si program studimi me kohë të plotë të organizuar me 120 kredite ECTS dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Ndarja e lëndëve në kurrikul është organizuar duke u bazuar në <i>VKM nr.41, datë 24.01.2018</i> për “elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë.</p> <p>Programi përcakton qartë të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit profesional-2 vjeçar “Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik” të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Në planin mësimor është përcaktuar ndarja e krediteve midis kurseve dhe semestrave, ndarja e veprimtarive formuese dhe peshat e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndarja e ngarkesës së orëve mësimore në auditor dhe ngarkesa e studimit individual. Gjithashtu caktohet edhe ngarkesa e provimit përfundimtar të diplomimit (6 kredite) që është parashikuar që të jetë 100% studim individual nga ana e studentit</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Ndarja e peshës së kategorive për veprimtaritë formuese është në përputhje me kërkesat ligjore për programet e studimit profesional perkatesisht:</p> <p>A - Lëndë disiplinore Bazë -15% - 18 kredite</p> <p>B - Lëndë disiplinore Karakterizuese – 50% - 60 kredite</p> <p>C - Lëndë Ndërdisiplinore – 20% - 24 kredite</p> <p>D - Lëndë Plotësuese - 10% - 12 kredite</p> <p>E - përgatitje e tezës së diplomës 5 % – 6 kredite</p> <p><i>Për të kompletuar elementët që përbëjnë strukturën e programit 2 -vjeçar profesional, Aplikacion ne Web dhe Dizenim Grafik në dokumentacionin shoqëruar gjeni edhe programin lëndor dhe formatin e miratuar suplementit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit 2- vjeçar profesional Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI). Kjo njësi ka në strukturën e saj 3 departamente si më poshtë⁹</p> <p>1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI)</p>

⁸ AEvidenca 8. Plani mesimor

⁹ Evidenca 6. Rregullore FTI neni 12, pika 2

shkallës së kualifikimit të stafit akademik.	<p>2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK)</p> <p>3. Departamenti i Matematikës (DM)</p> <p>Përbërja e FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK). Ky departament përbëhet në total nga 16 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë prej të cilëve 4 zotërojnë gradën shkencore doktor i shkencave.¹⁰</p> <p>Përbërja e DSHK dhe e departamenteve të tjera të FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Ndarja e peshës së kategorive për veprimtaritë formuese është në përputhje me kërkesat ligjore për programet e studimit profesional perkatesisht:</p> <p>A - Lëndë disiplinore Bazë -15% - 18 kredite</p> <p>B - Lëndë disiplinore Karakterizuese – 50% - 60 kredite</p> <p>C - Lëndë Ndërdisiplinore – 20% - 24 kredite</p> <p>D - Lëndë Plotësuese - 10% - 12 kredite</p> <p>E - përgatitje e tezës së diplomës 5 % – 6 kredite</p> <p>Për të kompletuar elementët që përbëjnë strukturën e programit 2 -vjeçar profesional, Aplikacion ne Web dhe Dizenim Grafik në dokumentacionin shoqërues gjeni edhe programin lëndor¹¹ dhe formatin e miratuar të suplementit.¹²</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁰ Evidenca 15. Personeli akademik në FTI

¹¹ Evidenca 9. Programet e lendeve AWDG

¹² Evidenca 10. Formatin e suplementit



II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Plani mësimor i programit 2 vjecar profesional Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik përmban të gjithë elementët e kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky program është i organizuar në: - 19 lëndë me frekuentim të vlerësuara përkatësisht nga 6 kredite secila - Provimin / temën e diplomimit që është vlerësuar me 6 kredite
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	Procesi mësimor organizohet në katër semestra të rregullt me kohëzgjatje 16 javë dhe me garkesë 30 kredite për semestër (2 vite akademike). Çdo semestër përmban 5 lëndë (4 me detyrim dhe 1 me zgjedhje) me përjashtim të semestrit të fundit që përmban 4 lëndë (3 me detyrim dhe 1 me zgjedhje) si dhe detyrimet përmbyllëse të provimit / temën e diplomës.
Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.	Ngarkesa për çdo lëndë me frekuentim është 45 orë në auditor dhe 105 orë studim individual. ¹³ Frekuentimi dhe mënyra e vlerësimit të studentëve është e unifikuar për të gjitha kurset. Frekuentimi i orëve mësimore ¹⁴ është i detyrueshëm në masën 75%. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem pikëzimi prej 1000 pikësh, i cili konvertohet me notë në proces-verbalin përfundimtar ku nota kaluese më e ulët është nota pesë e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara. ¹⁵ Vlerësimi bëhet përgjatë semestrit dhe bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga: 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%)
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.	Kriteret pranuese dhe kuotat përcaktohen çdo fillim viti akademik nga DSHK / FTI dhe dërgohen për miratim përfundimtar në Senatën Akademik të UAMD. Çdo lëndë ka programin lëndor sipas formatit të pëcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. ¹⁶ Ky program lëndor miratohet në departamentin që mbulon lëndën të paktën 10 ditë përpara fillimit të mësimit. Ditën e parë të mësimit, lektori i lëndës duhet të informojë studentët në lidhje me programin lëndor dhe rregullat e vlerësimit. ¹⁷
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundur formimin e studentëve përgjatë programit dhe në	Personeli akademik i lëndës ka lirinë akademike për të propozuar në departament ndryshimet në programin lëndor në funksion të përditësimit dhe të përmirësimit të tematikave që këto lëndë trajtojnë. Ky proces bëhet çdo fillim semestri dhe ndryshimet e propozuara

¹³ Evidenca 8. Plani mesimor AWDG

¹⁴ Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 66

¹⁵ Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 68

¹⁶ Evidenca 11. Plani mesimor AWDG

¹⁷ Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 62



përshtatje me punësimin.	miratohen në departament përpara fillimit të procesit mësimor për atë semestër. Përgjegjësi i departamentit ruan çdo fillim semestri programet lëndore për të gjitha kurset e ofruara në atë semestër për programin 2 vjeçar profesional Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik.			
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Lëndët e vitit të parë ofrojnë përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme, lëndë plotësuese si dhe lëndët bazë karakterizuese si: HTML dhe CSS, Perpunim Imazhi, Adobe Illustrator, Java Script etj . Objektivi i vitit të parë është të mundësojë që studenti të integrohet gradualisht me ambientin universitar, metodologjinë e mësimdhënies, rregulloren e Universitetit etj. - Gjatë vitit të dytë studenti frekuenton lëndë karakterizuese profesionale për të përfutur bazat e nevojshme teorike edhe praktike për formimin e tyre profesional. Objektivi i lëndëve të vitit të dytë është që ti ofroj studentëve njohuritë karakterizuese e nevojshme profesionale duke i prezantuar ata me teknologjitë dhe sistemet kompjuterike, bazat e të dhënave si dhe sintaksën e gjuhëve të programimit web.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Përmbajtja e lëndëve përshtatet plotësisht me emërtimin e tyre. Përmbajtja e programit të studimit si dhe shpërndarja e zhvillimit të lëndëve realizohet për të arritur aftësimin e studenteve bazuar në nivelin e vështirësisë së lëndëve, ndërlihdjen midis tyre, kërkesat e tregut të punës si dhe kërkesat për vazhdimësinë e studimeve për programet e ciklit të dytë.
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe punësimin e studentëve.	Objektivi përfundimtar i këtij programi studimi është që të formojë profesionistë në fushën e aplikacioneve web dhe dizenjimit grafik. Të gjitha lëndët që përmban kurrikula dhe shpërndarja e tyre janë në funksion të këtij objekti.
Kriteri 3. Planin mësimor, natyrën dhe emërtimin e moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Planin mësimor i programit 2 vjeçar profesional Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik përmban të gjithë elementët e kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky program është i organizuar në: - 19 lëndë me frekuentim të vlerësuara përkatësisht nga 6 kredite secila - Provimin / temën e diplomimit që është vlerësuar me 6

	<p>kredite</p> <p>Procesi mësimor organizohet në katër semestra të rregullt me kohëzgjatje 16 javë dhe me garkesë 30 kredite për semestër (2 vite akademike). Çdo semestër përmban 5 lëndë (4 me detyrim dhe 1 me zgjedhje) me përjashtim të semestrit të fundit që përmban 4 lëndë (3 me detyrim dhe 1 me zgjedhje) si dhe detyrimet përmblylëse të provimit / temën e diplomës.¹⁸</p>			
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Në planin mësimor të programit të studimit 2- vjecar Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik mbi 50 % e lëndëve kanë karakter profesional të cilat zhvillohen në laboratorët që aktualisht zotëron FTI. Kurse si : Përpunim Imazhi, Adobe Illustrator, HTML dhe CSS, Adobe Indesign, Php & MySql, Word Press etj janë kurse me karakter praktik.</p>			
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Ngarkesa për çdo lëndë me frekuentim është 45 orë në auditor dhe 105 orë studim individual.¹⁹ Frekuentimi dhe mënyra e vlerësimit të studentëve është e unifikuar për të gjitha kurset. Frekuentimi i orëve mësimore²⁰ është i detyrueshëm në masën 75%. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem pikëzimi prej 1000 pikësh, i cili konvertohet me notë në proces-verbalin përfundimtar ku nota kaluese më e ulët është nota pesë e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara.²¹ Vlerësimi bëhet përgjatë semestrit dhe bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%) <p>Kriteret pranuese dhe kuotat përcaktohen çdo fillim viti akademik nga DSHK / FTI dhe dërgohen për miratim përfundimtar në Senatën Akademik të UAMD. Çdo lëndë ka programin lëndor sipas formatit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi.²² Ky program lëndor miratohet në departamentin që mbulon lëndën të paktën 10 ditë përpara fillimit të mësimin. Ditën e parë të mësimin, lektori i lëndës duhet të informojë studentët në lidhje me programin lëndor dhe rregullat e vlerësimit.²³</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹⁸ Evidenca 8. Plani mesimor AWDG

¹⁹ Evidenca 8. Plani mesimor AWDG

²⁰ Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 66

²¹ Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 68

²² Evidenca 9. Programet e lëndëve

²³ Evidenca 3. Rregullore UAMD, neni 62

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi				
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Përmbajtja e lëndëve përshtatet plotësisht me emërtimin e tyre. Përmbajtja e programit të studimit si dhe shpërndarja e zhvillimit të lëndëve realizohet për të arritur aftësimin e studenteve bazuar në nivelin e vështirësisë së lëndëve, ndërlidhjen midis tyre dhe kërkesat e tregut të punës.				
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkua/të pritshme nga punëdhënësit.	Objektivi përfundimtar i këtij programi studimi është që të formojë profesionistë në fushën e Aplikacioneve Web dhe Dizenjimit Grafik. Të gjitha lëndët që përmban kurrikula dhe shpërndarja e tyre janë në funksion të këtij objekti.				
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	Përmbajtja e lëndëve përshtatet plotësisht me emërtimin e tyre. Përmbajtja e programit të studimit si dhe shpërndarja e zhvillimit të lëndëve realizohet për të arritur aftësimin e studenteve bazuar në nivelin e vështirësisë së lëndëve, ndërlidhjen midis tyre dhe kërkesat e tregut të punës.				
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Përditësimi i programit të lëndëve (syllabus dhe material mësimore) realizohet periodikisht duke u bazuar në literaturat e reja apo zhvillimet më të fundit teknologjike. Meqënëse programi I studimit AWDG është hapur në vitin 2020 ende nuk kemi bërë ristrukturim të kurrikulave.				
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Përfshirja dhe përvoja praktike gjatë edukimit po tregohet gjithnjë më e suksesshme se arsimit i përgjithshëm në promovimin e karrierës së të rinjve. Vendet me përqindjen më të lartë të studentëve që studiojnë dhe punojnë në të njëjtën kohë, kanë dhe kohëzgjatjen mesatare më të shkurtër ndërmjet mbarimit të arsimimit dhe fillimit të një pune. Në fakt, meqë shumica e këtyre studentëve kombinojnë punën dhe edukimin, ata do të vihen në kontakt me punëdhënësit relativisht më shpejt. Vetëpunësimi gjithashtu është një nga mundësitë që specialistët në fushën e Aplikacioneve Web dhe Dizenjimit Grafik që po e shfrytëzojnë më së shumti kohët e fundit. Kjo mënyrë punësimi nënkupton se vetë specialisti ofrohet për të qënë dizenjues apo krijues I faqeve web dhe materialeve promovionale. Ky lloj punësimi njihet si “freelancer” dhe një numër i madh profesionistësh e shfrytëzojnë si punë primare ose si një mundësi për të punuar me kohë të pjesshme.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
---	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------




				X
--	--	--	--	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Në zbatim të nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkit Shkencor, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohet se njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë. Misioni i kësaj Drejtorie / NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim.²⁴</p> <p>NJBSC është ngritur edhe në nivel fakulteti për FTI.</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Në programin 2 vjecar Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik mësimi zhvillohet si ndërthurje e elementëve të mëposhtëm:²⁵</p> <ul style="list-style-type: none"> a) leksione; b) Leksione te integruara me praktiken c) Ushtrime d) Praktike e) projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; f) provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; g) konsultime individuale ose në grupe me pak studentë;
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Është e drejta e personelit akademik të lëndës për të kombinuar këto elementë për të arritur objektivat e përcaktuar në programin e lëndës si dhe për tu përshtatur me kërkesat e studentëve dhe nevojat e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>FTI në bashkëpunim me partnerët e biznesit (Crystal System) si dhe nga investimet e përfuara nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, ofron për studentet dhe për anëtarët e personelit akademik kushtet optimale për të punuar dhe për të praktikuar të gjithë elementët e mësimin si dhe për të eksperimentuar metoda alternative të mësimdhënies.²⁶ Auditorët në dispozicion të këtij programi janë të hapur për studentët edhe jashtë orarit mësimor dhe ofrojnë kushtet teknike dhe programet e nevojshme për praktikën e tyre dhe zhvillimin e projekteve të ndryshme. Personeli akademik mund të përdori teknologjitë audio / video, PC dhe internet të dedikuar për zhvillimin e procesit mësimor dhe praktikës mësimore. Çdo kërkesë e personelit akademik / studentëve për</p>

²⁴ Evidenca 17. Rregullore NJBSC, Neni 8

²⁵ Evidenca 6. Rregullore FTI, neni 43, pika 3

²⁶ Evidenca 11. Relacion për praktikatat profesionale

	kushtet e mësimit merret në konsideratë dhe aplikohet në afate të shkurta kur konsiderohet e përshtatshme. ²⁷			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Personeli akademik informohet në mënyrë periodike në lidhje me kërkesat e biznesit për lëndën që mbulon dhe në lidhje me opinionin dhe sugjerimet e studentëve duke u angazhuar në përmirësimin e përbajtjes së lëndës dhe në përshtatjen e metodologjisë së mësimdhënies. Studentët kanë mundësi të shprehin opinionin e tyre duke komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me lektorin e lëndës, koordinatorin e programit të studimit ose me drejtuesit e FTI ose duke plotësuar anketimin në përfundim të kursit që organizohet në nivel institucional.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Aktualisht FTI zotëron 3 laboratorë programimi (sallat 101, 111 dhe 211) të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profili, 2 laboratorë të profilit të multimedias (sallat 103 dhe 203) si dhe një laborator kërkimor (salla 015). Këta laboratorë kanë lidhje interneti, 20-30 PC me parametra të përshtatshëm dhe të kompletuar me programet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor dhe praktikat profesionale, LED screen 65" ose projektore HD për zhvillimin e procesit mësimor në kushte optimale, kamera survejimi, një laborant të dedikuar vetëm për mirëmbajtjen teknike të këtij laboratori dhe për atë asistuar stafin akademik që zhvillon procesin mësimor dhe praktikat në këtë laborator, sistem kondicionimi, kapacitet për zhvillim leksionesh për 40-60 studentë, laptop për stafin akademik që zhvillon aktivitetin mësimor në këtë laborator. ²⁸
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Të gjitha kurset profesionale për këtë program studimi e zhvillojnë aktivitetin e tyre në këto ambiente. Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2021-2022 është planifikuar të përfundojnë edhe dy laboratorë të tjerë, një laborator mësimor dhe një në mbështetje të zhvillimit të

²⁷ Evidenca28. Labororet në UAMD

²⁸ www.uamd.edu.al

	<p>praktikave mësimore dhe kërkimore.</p> <p>Përveç përdorimit të këtyre ambjenteve, FTI ka në përdorim edhe 7 auditorë mësimor me kapacitet total 420 vende (sallat 104, 105, 107, 108, 110, 210, 220).</p>		
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>E gjithë literatura e detyruar e kurseve ofrohet në gjuhën e programit të studimit (shqip). Kjo literaturë është e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara për këtë program studimi.</p>		
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Laboratorët mësimore dhe kërkimore janë në funksion të studentëve të programit 2 vjeçar AWDG edhe jashtë orarit mësimor. Këta laboratorë i ofrojnë mundësinë studentit për të përdorur njësinë e tij të punës, akses në internet dhe programet kompjuterike të nevojshme për të punuar në lidhje me projektet apo praktikën mësimore apo për studim.</p>		
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Përveç ambjenteve të laboratorëve, studentët kanë akses edhe në bibliotekën e UAMD. Ambjentet e bibliotekës ofrojnë PC, programe të përshtatshme sipas programeve të studimit të studentëve, akses në literaturë fizike në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj sipas fakulteteve, akses në biblioteka online bazuar në marrëveshjet e UAMD.</p> <p>Çdo vit personeli akademik propozon literatura të ndryshme sipas profileve për pasurimin e bazës materiale të bibliotekës. Bazuar në këto propozime UAMD përditëson fondin ekzistues bazuar në buxhetin e miratuar për këtë funksion për atë vit akademik.</p>		
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Prej 3 vitesh i gjithë stafi akademik i UAMD përdor platforma online për të rritur cilësinë e procesit mësimor duke përdorur platforma të ndryshme si: Google Classroom, Microsoft Teams, Moodle etj. Në këto platforma studentët marrin informacione dhe leksione nga lektorët dhe gjithashtu ngarkojnë projekte individuale dhe punë laboratorike në këto platforma.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Struktura përgjegjëse në nivel institucional për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies është NJBSC e UAMD²⁹. Në bashkëpunim me strukturat e FTI, kjo strukturë realizon në mënyrë periodike aktivitete për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies (anketime, trajnime etj.), të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi								
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Struktura përgjegjëse në nivel institucional për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies është NJBSC e UAMD ³⁰ . Në bashkëpunim me strukturat e FTI, kjo strukturë realizon në mënyrë periodike aktivitete për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies (anketime, trajnime etj.)								
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Personeli akademik informohet në mënyrë periodike në lidhje me kërkesat e biznesit për lëndën që mbulon dhe në lidhje me opinionin dhe sugjerimet e studentëve duke u angazhuar në përmirësimin e përmbajtjes së lëndës dhe në përshtatjen e metodologjisë së mësimdhënies. Studentët kanë mundësi të shprehin opinionin e tyre duke komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me lektorin e lëndës, koordinatorin e programit të studimit ose me drejtuesit e FTI ose duke plotësuar anketimin në përfundim të kursit që organizohet në nivel institucional.								
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një eksperiencë të gjatë akademike si personel akademik me kohë të plotë pranë UAMD. 75% e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë të punësuar me kohë të plotë në UAMD dhe kanë një eksperiencë disa vjeçare në këtë profesion. Lëndët kanë në programin e tyre edhe një projekt individual ose në grup që zhvillohet përgjatë kohëzgjatjes së semestrit nën mbikëqyrjen e personelit akademik të lëndës duke inkurajuar punën në grup midis studentëve, të menduarit kritik si dhe bashkëpunimin lektor-student.								
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	Duke u bazuar në marrëveshjet dhe projektet Erasmus Plus ³¹ dhe jo vetëm me partnerë evropianë personeli akademik i UAMD kryen trajnime dhe mësimdhënie të vazhdueshme në Universitete në vendet e BE duke e imlementuar këtë experiencë në mësimdhënie dhe duke e ndarë me kolegët nëpërmjet takimeve apo mbledhjeve të Njesisë Bazë.								
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

³⁰ Evidenca 18. Urdhër ngritjeje NJSBC

³¹ Evidenca 21. Universitetet partnere

Standardi III.4

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e përcaktuar qartë në rregulloret e institucionit³² dhe është e unifikuar për të gjitha lëndët e ofruara në programin bachelor dhe 2 vjecar profesional</p> <p>Vlerësimi bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%)
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Provimi i ndërmjetëm realizohet në mes të semestrit (java 7/8) kurse provimi përfundimtar në përfundim të semestrit (java 15/16). Në rast se studenti nuk arrin të fitojë pikët e nevojshme për të kaluar lëndën atëhere ai mund të zgjedhë ta rifrekutojë këtë lëndë në vitin pasardhës ose ta regjistrojë për riprovim (testim unik me 1000 pikë) në sezonet përkatëse (dimër, verë, vjeshtë). Vlerësimi bazuar në pikët e përfuara është:</p> <p>Nota 4: 0 – 504 pikë; nota 5: 505-574 pikë; nota 6: 575-664 pikë; nota 7: 665-754 pikë; nota 8: 755-844 pikë; nota 9: 845-934 pikë; nota 10: 935-1000 pikë.</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Kjo është një praktikë e konsoliduar në UAMD dhe e përcaktuar si detyrim për tu realizuar nga personeli akademik i lëndës edhe në rregulloret e institucionit.³³</p> <p>Gjithashtu gjatë javës së parë të mësimit FTI organizon javën e orientimit për të informuar studentët e viteve të para në lidhje me rregullat e vlerësimit dhe jo vetëm.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive për lëndët e programit 2- vjecar Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik realizohet gjatë kohëzgjatjes së mësimet. 40% e vlerësimit të studentëve realizohet me testimin e ndërmjetëm që zhvillohet në mes të ngarkesës mësimore të lëndës dhe 50% e vlerësimit bazohet në provimin përfundimtar në përfundim të lëndës. Përgjatë zhvillimit të mësimet studenti përgatit edhe detyrat/projektin e kursit që u përcaktohet nga personeli akademik në fillim të procesit mësimor. Ky projekt mbrohet në javën e fundit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar.³⁴</p> <p>Mënyra e vlerësimit është e pasqyruar në syllabus-in e çdo kursi në përputhje me përcaktimet e akteve rregullore të FTI / UAMD.</p>

³² Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 68

³³ Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 62, pika 3

³⁴ Evidenca 5. Rregullore UAMD, neni 68

<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>FTI garanton të drejtën e çdo studenti për tu njohur me vlerësimin si dhe për të marë një informacion të detajuar nga personeli akademik i kursit në lidhje me mënyrën e vlerësimit së bashku me identifikimin e gabimeve që studenti ka bërë në testim. Për çdo provim, personeli akademik i kursit informon studentët për ditën, sallën dhe orarin kur studentët mund të bëjnë ballafaqimin e rezultateve të provimit.</p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësiwe profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Pasi personeli akademik ka bërë ballafaqimin e rezultateve me studentët, duhet të dorëzojë pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve përfundimtare (dhe në sistem) së bashku me provimet jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit. Në rast se studenti, edhe pas ballafaqimit të rezultateve me personelin akademik, nuk është i bindur për saktësinë e vlerësimit atëherë ai ka të drejtë që brenda afateve të parashikuara në rregullore të paraqesë në dekanat një kërkesë me shkrim për rishikim të vlerësimit të provimit.³⁵</p>			
	<p>Në rastet kur kërkesa miratohet atëherë departamenti ngre një komision vlerësimi të përbërë nga personel akademik të asaj disipline. Personeli akademik i seksionit nuk mund të jetë anëtar i komisionit të rishikimit. Komisioni përcakton ditën dhe orën e rishikimit duke informuar studentin dhe personelin akademik të seksionit dhe bën rivlerësimin e tezës në prezencën e tyre. Komisioni del me një vendim për rezultatin e vlerësimit.</p> <p>E gjithë procedura ruhet në protokollin e FTI.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5 Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësiwe krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësiwe profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Programi i studimit 2 vjeçar Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në fushën e dizenjimit grafik dhe krijimit të faqeve web, garanton thellimin e njohurive veçanërisht në aftësitë e studentëve të këtij programi për ndërtimin e faqeve web, materialeve promovuese për shtyp dhe rrjete sociale, faqesje librash e revistash etj.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësiwe të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e</p>	<p>Si pjesë e FTI, ky program studimi është kryesisht i fokusuar në zhvillimin e njohurive në fushën dizajnit dhe programimit web.</p>

³⁵ Evidenca 5. Rregullore e UAMD neni 71

<p>problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në javën që i paraprin provimit, programi i lëndës parashikon orën e përsëritjes së programit mësimor të trajtuar gjatë zhvillimit të lëndës.³⁶ Personeli akademik i lëndës udhëzon studentët në lidhje me provimin përfundimtar si dhe i përgjigjet pyetjeve të tyre në lidhje me paqartësitë që ata mund të kenë në lidhje me tematika të caktuara.</p> <p>Në këtë javë realizohet edhe mbrojtja e detyrave / projekteve të kursit. Cilësia e këtyre detyrave / projekteve duhet të pasqyrojë edhe kompetencat që studentët kanë përfutur gjatë zhvillimit të lëndës. Midis të tjerash, këto detyra / projekte kanë si qëllim nxitjen e punës në grup midis studentëve dhe të diskutimeve konstruktive ndërmjet tyre. Këto detyra / projekte bazohen në zgjidhjen e problematikave / çështjeve të caktuara që miratohen nga personeli akademik i lëndës në javët e para të mësimt.</p> <p>Në rastet kur këto projekte pasqyrojnë cilësi të lartë kërkimore ose ide inovative, personeli akademik inkurajon studentët për të prezantuar punën e tyre në aktivitetet e organizuara nga FTI³⁷ si workshope, konferenca etj. Këto aktivitete promovojnë punët e studentëve dhe mbështeten financiarisht nga UAMD dhe nga biznese partnere. Bazuar në rezultatet e provimit si dhe cilësinë e detyrave / projekteve të kursit, stafi akademik i lëndës planifikon përshtatjet e nevojshme për vitin e ardhshëm akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në javën që i paraprin provimit, programi i lëndës parashikon orën e përsëritjes së programit mësimor të trajtuar gjatë zhvillimit të lëndës.³⁸ Personeli akademik i lëndës udhëzon studentët në lidhje me provimin përfundimtar si dhe i përgjigjet pyetjeve të tyre në lidhje me paqartësitë që ata mund të kenë në lidhje me tematika të caktuara.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Në përfundim të programit të plotë të studimeve studentit ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës. Për programet e studimit 2 vjecar diplomimi bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Studenët që plotësojnë kushtet duhet të paraqesin pranë sekretarises mësimore kërkesën për tu regjistruar në provim të plotësuar sipas formatit të miratuar të paktën dy javë përpara provimit të diplomimit.³⁹</p>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Studimet e programit 2 vjecar Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik përmbillen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Për të marrë pjesë në provimin e diplomës studentit duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e tjera të kurrikulës. Ai mund të regjistrohet vetëm pasi shlyerja e këtyre detyrimeve konfirmohet nga sekretaria mësimore e FTI.⁴⁰ Procedura e organizimit dhe e vlerësimit të provimit të diplomës pasqyrohet në rregulloren e FTI.⁴¹</p>

³⁶ Evidenca 9. Programet e lëndëve

³⁷ Evidenca 19/20. Konferenca studentore dhe workshop

³⁸ Evidenca 9. Programet e lëndëve

³⁹ Evidenca 5. Rregullore UAMD neni 75

⁴⁰ Evidenca 6. Rregullore FTI, neni 59, pika 3

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	<p>Rekrutimi i personelit akademik pranë FTI zhvillohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe sipas procedurave të pasqyruara në rregulloret e UAMD ⁴²</p> <p>FTI / UAMD shpall konkursin për vende të lira pune, sipas strukturës së përgjithshme në nivel institucional, të miratuar nga Bordi Administrimit dhe kryen publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu njoftimet publikohen dhe në faqen zyrtare të UAMD së bashku me formularët e aplikimit.</p> <p>Vetëm dosjet e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe protokollohen, sipas rregullave në fuqi.</p> <p>Drejtuuesi i njësisë kryesore krijon komisionin <i>ad hoc</i> për përzgjedhjen e kandidatëve fitues sipas përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi dhe Statutit të UAMD- es.</p> <p>Komisioni bën vlerësimin e kandidaturave në dy faza, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Vlerësimi i kandidaturave për personel akademik bazohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> I. Vlerësimi i dosjes përmban 70% të vlerësimit; II. Intervista e cila përmban 30% të vlerësimit; ⁴³
Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e	Drejtorja e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë organizon punën për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe shpërndarjen e formularëve standardë për çështje të tilla si pyetësorët për studentët, administratën

⁴¹ Aneks 6. Rregullore FTI, nenet 59-62

⁴² Aneks 5. Rregullore UAMD nenet 103, 106

⁴³ Aneks2. Statuti UAMD Neni 45
Aneks 5. Neni 103

<p>personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni, bazuar në formatet e miratuara nga NJSBC dhe KPGSC dhe udhëzimet përkatëse. 2. Administron dokumentacione që lidhet me sigurimin e cilësisë për të gjithë universitetin dhe bazuar në kërkesa sipas rastit nga NJSBC, kërkon informacione zyrtare nga fakultetet mbi treguesit e cilësisë që lidhen me fushën akademike apo kërkimore shkencore. Përpunon pyetësorët e vlerësimit të pedagogëve dhe institucionit nga studentët dhe I shpërndan rezultatet NJSBC-së dhe të gjitha strukturave përkatëse.⁴⁴</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin 2 vjecar profesional AWDG është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI). Kjo njësi ka në strukturën e saj 3 departamente si më poshtë: ⁴⁵</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI) 2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK) 3. Departamenti i Matematikës (DM) <p>Përbërja e FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Ky departament përbëhet në total nga 16 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë prej të cilëve 4 zotërojnë gradën shkencore doktor i shkencave</p> <p>Përbërja e DSHK dhe e departamenteve të tjera të FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Stafi akademik I UAMD kryen trajnime të vazhdueshme me partnere europiane ⁴⁶ dhe në "Qendra edukim në vazhdim"⁴⁷ krijon kushte të përshtatshme për realizimin e kërkimit shkencor, për trajnimet e stafit akademik dhe mbështetjen dhe realizimin e hapjes së programeve të reja të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme

⁴⁴ Evidenca 17. Rregullore e NJCBC neni 10

⁴⁵ Evidenca 6. Rregullore e FTI neni 6

⁴⁶ Evidenca 13. Marrveshjet e UAMD

⁴⁷ Evidenca 27. Neni 4

për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi								
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Aktualisht FTI zotëron 6 laboratorë (sallat 015, 101, 111, 211, 103, 203) të teknologjisë së informacionit të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe për lëndë të ndryshme me karakter profesional. Laboratorët kanë linjë interneti të dedikuar, PC me parametra të përshtatshëm dhe të kompletuar me programet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor praktik, kamera survejimi, sistem kondicionimi, si dhe laborant të dedikuar vetëm për mirëmbajtjen teknike të këtyre laboratorëve dhe për të asistuar stafin akademik që zhvillon procesin mësimor në këto laboratore.</p> <p>Pjesa më e madhe e lëndëve që synojnë aftësimin profesional dhe praktik të studentëve zhvillohen në laborator duke shfrytëzuar pajisjet dhe programet e specifike për realizimin e objektivave të kursit përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><i>(Evidenca 42 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (sallat/ laboratorët/ studiot/ atelietë/ platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online); hapësirat ndihmëse; raporti ekspertit për infrastrukturën</i></p> <p>Për zhvillimin e leksioneve dhe lëndëve teorike përdoren sallat e tjera (104, 105, 107, 108, 110, 210, 220 me kapacitet total 420 vende) që janë në funksion të NJKTI të cilat janë të pajisura me sistem kondicionimi ngrohje/frohje, ndriçim, hapsira të mjaftueshme mëse komde për numrin e studentëve dhe në rastet e nevojshme, mësimi zhvillohet me video-projektor.</p>								
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>									
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>									
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>									
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>									
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedisë mbështetëse e të posaçme të

mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijojnë kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Në mjediset e UAMD (Godina nr.1, Currila) ndodhet Biblioteka, e cila arkivon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve, e studiuesve.</p> <p>Ajo funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 8576, datë 3.2.2000, Neni 30, "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë". Ajo kryen dixhitalizimin e skedarëve dhe ka në fondin e saj rreth 12000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line,⁴⁸ në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka universitare garanton literaturë kryesisht të viteve të fundit, tekste mësimore dhe plotësuese, në përputhje me kurrikulat mësimore. Numri i kopjeve për çdo titull varion nga 2-5 kopje mesatarisht, ndërsa kopjet e librit të huaj variojnë nga 1- 2 kopje. Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik, (mbi 10000 tituj).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Çdo student/ pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave, për navigimin në burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik.⁴⁹</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Gjatë javës së orientimit për studentët e vitit të parë (java e parë e mësimit), studentët informohen edhe për ambientet dhe infrastrukturën e FTI që është në dispozicion të studentëve përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre.</p> <p>Përsa i përket ambienteve mësimore, informacioni për ambientet ku do zhvillohet mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në sistemin Pitagora. Sistemi Pitagora është sistemi që përdor UAMD dhe FTI për menaxhimin dhe komunikimin e studentëve në lidhje me cdo aktivitet të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:⁵⁰</p> <ol style="list-style-type: none"> Buxheti i Shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; veprimtari kërkimore-shkencore; <p>3. Institucionet publike të arsimit të lartë rregullojnë në aktet e tyre të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të të ardhurave nga Buxheti i Shtetit.</p>
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve</p>	

⁴⁸ Evidenca 22. Biblioteka online

⁴⁹ Evidenca 23. Rregullorja e Bibliotekës Shkencore të UAMD neni 3 pika 3.2

⁵⁰ Evidenca 14. Ligji për arsimin e lartë neni 109 dhe 110

dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Çdo fillim viti akademik, DSHK propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin profesional 2- vjeçar Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik. Këto kritere pranimi miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet e DSHK dhe FTI. ⁵¹ Këto kritere, si të gjitha vendimet e senatit, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD. Gjithashtu njoftimet për kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet publikohen edhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD dhe FTI. ⁵²
Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.	Cdo fillim viti akademik, DSHK parashikon kuotat dhe propozon kriteret per pranimin e studenteve ne programin 2 vjeçar Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik. Këto kritere pranimi miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet e DSHK ⁵³ dhe FTI Këto kritere, si të gjitha vendimet e senatit, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD. Gjithashtu njoftimet për kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet publikohen edhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD dhe FTI. ⁵⁴ Përveç publikimeve në faqen elektronike zyrtare të UAMD dhe në rrjete sociale, këto kritere janë të publikuara edhe në portalin U-Albania ku çdo maturant mund ta aksesojë lehtësisht.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit	Rregullorja e institucionit dhe e njërive kryesore ka procedura të qarta dhe të publikuara online të hapave dhe strukturave që organizojnë procesin e studimeve të studentëve. Përtej procedurave, në fillim të çdo

⁵¹ Evidenca 6. Rregullore FTI, neni 29

⁵² <https://www.facebook.com/FTIUAMD/> dhe <https://www.facebook.com/uamdofficial/>

⁵³ Evidenca 1. Propozimi I DSHK

⁵⁴ <https://www.facebook.com/FTIUAMD/> dhe <https://www.facebook.com/uamdofficial/>

<p>akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimi të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>faze studentët informohen nga sekretaria e FTI dhe nëpërmjet medimeve online të komunikimit.⁵⁵</p>			
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Insitucioni në mënyrë periodike në fillim të procesit të maturantëve për përzgjedhjen e programit të studimit, me miratimin e Ministrisë ndërmerr fushata informomimi dhe promovimi të programeve të studimit që ai zotëron. Gjithashtu ka plane dhe strategji të posacme marketingu për promovimin e programit të studimit. Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun;</p> <p>Veprimtari informuese përfshijmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takime informuese në gjimnaze për maturantët - Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale - Video informuese dhe publicitare mbi programin e studimit që publikohen nëpër rrjete sociale. - Takime dhe Open Days informuese mbi infrastrukturën dhe informacione mbi programin e studimit. <p>Broshura hard dhe soft copy informuese mbi programet e studimit.⁵⁶</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me mënyrën e vlerësimit për çdo lëndë nga lektorët përkatës. Syllabusi i cdo lënde i jepet studentit sëbashku me sistemin e vlerësimit. Mënyra e vlerësimit është me dy provime, të cilët kanë përkatësisht një vlerësim prej 400 pikë i pari dhe 500 pikë i dyti. Ndërkohë që një vlerësim prej 100 pikë i përket detyrave të kursit apo projektit të dhënë prej pedagogut të lëndës. Në total studenti do të mund të përfitojë 1000 pikë maksimale. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara. Gjithashtu sistemi i vlerësimit gjentet tek rregullorja e UAMD, e cila është e publikuar dhe online në faqen e WEB-it të institucionit.⁵⁷</p>			
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Website i UAMD-së, Sistemi i menaxhimit të studentëve dhe procesit mësimor <i>Pitagora</i>, Faqet zyrtare të intitucionit dhe FTI në rrjetet sociale janë format më të përhapura dhe më transparente të publikimit të informacionit dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët.⁵⁸</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

⁵⁵ Evidenca 5. Rregullore e UAMD Kreu 3 /
Evidenca 6. Rregullore e FTI kreu 3

⁵⁶ Materiale promovuese folder

⁵⁷ Evidenca 5. Rregullore e UAMD neni 68
Evidenca 6 Rregullore e FTI neni 52

⁵⁸ www.uamd.edu.al

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Aktualisht në funksion të FTI është sistemi Pitagora i cili administrojnë të dhënat e studentëve dhe i ofron atyre një hapsirë vetjake për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, perzgjedhur lëndët gjatë sezonit të riprovimeve, aksesuar bibliotekën online etj. Ky sistem ofrohet në bashkëpunim me RASH. ⁵⁹			
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Çdo përdorues për sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FTI/UAMD: - Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. - Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj. - Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	- Në këtë sistem janë të përfshira ndërfaqet për studentët, personelin akademik, sekretarinë mësimore dhe zyrën e finances për verifikimin e pagesave.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	- Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera Këto të dhëna janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtarit të personelit të FTI. Të dhënat janë të ruajtura për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FTI.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Të dhënat për programin profesional 2- vjecar Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik janë të publikuara në faqen zyrtare të UAMD në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. ⁶⁰			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

⁵⁹ <https://uamd.pitagora.rash.al>

⁶⁰ <https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në legjislacionin në fuqi, përcaktimi i kriterëve pranuese të programin profesional 2 vjecar AWDG kalon për miratim në të gjitha njësitë përgjegjëse për këtë program studimi (DSHK, FTI, rektorat, senat akademik, MAS) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UAMD si dhe në portalin U-Albania për të gjithë maturantët. Bazuar në udhëzimet dhe periudhat e përcaktuara nga MAS realizohet edhe shpallja e fituesve si dhe regjistrimi i tyre me dokumentacionin e kërkuar dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim. Për transparencë i gjithë ky proces aplikohet në sistemin U-Albania ku çdo aplikant mund të informohet për rezultatin dhe ecurinë e aplikimit të tyre.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UAMD ⁶¹ duke siguruar një vlerësim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. Gjatë këtij procesi aplikantët kanë edhe mundësinë e ankimit por deri më sot për programet e studimit të FTI asnjëherë nuk ka pasur raste të tilla.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzoi publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Çdo fillim viti akademik, DSHK propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin 2 vjecar AWDG. Këto kriteret pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet e DSHK dhe FTI. ⁶² Këto kriteret, si të gjitha vendimet e senatit, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD. Gjithashtu njoftimet për kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet publikohen edhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD dhe FTI. ⁶³
Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin,	Koordinatori i programit 2 vjecar AWDG si dhe drejtuesit e DSHK dhe FTI organizojnë takime periodike me studentët e këtij programi për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për ti informuar për çdo kërkesë dhe afat që ndikon në përparimin e tyre akademik.

⁶¹ Evinca 24. Vendim per Kuotat

⁶² Evidenca 6. Rregullore FTI, neni 29

⁶³ <https://www.facebook.com/FTIUAMD/> dhe <https://www.facebook.com/uamdofficial/>

procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.									
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e FTI. ⁶⁴ Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme.								
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Ndër vite në mënyrë periodike FTI organizon ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si: - ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambjentet universitare të FTI dhe të marr informacion rreth ketij fakulteti. - Takime informuese në gjimnaze për maturantët - Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale ⁶⁵ - Takime informuese online me grupe maturanësh në rang gjimnazesh								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Çdo student në momentin e regjistrimit në programin 2 vjecar profesional AWDG mer nga sekretaria mësimore kurrikulën e programit të studimit ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje).
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë javës së orientimit për studentët e vitit të parë (java e parë e mësimi), studentët informohen edhe për ambjentet dhe infrastrukturën e FTI që është në dispozicion të studentëve përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre. Përsa i përket ambjenteve mësimore, informacioni për ambjentet ku do zhvillohet mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në sistemin Pitagora.
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes	Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar) ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të

⁶⁴ Evidenca 6. Rregullore FTI, neni 38 dhe neni 39

⁶⁵ Evidenca 25 . Urdhri per gruper e promovimit

sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	dhënat dhe statistikatat mund të përpunohen edhe nga sistemi Pitagora ⁶⁶			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Sekretaria dhe Kryesekretaria mbajnë dhe krijojnë baza të dhënash me të dhënat e studentëve që regjistrohen në programin e studimit, me rezultatet e tyre gjatë kohës së studimit si dhe numrin e studentëve të diplomuar dhe i përcjellin ato te drejtuesit e DSHK ⁶⁷ dhe FTI dhe në zyrën e ALUMNI.
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar) ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikatat mund të përpunohen edhe nga sistemi Pitagora. Programi i studimit 2 vjecar në “Aplikacion Web dhe Dizajnim Grafik” është ndër programet 2 vjecar me numrin më të madh të kërkesave dhe regjistrimeve. Përsa i përket gjurmimit të studentëve pas diplomimit të tyre është përgjegjësi e ALUMNI. Të gjitha këto të dhëna (me përjashtim të të dhënave të punësimit) disponohen nga sekretaria mësimore e FTI-së e cila i përcjell ato te drejtuesit e DSHK dhe FTI dhe në zyrën e ALUMNI.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.	Sipas politikave të sigurisë dhe ruajtjes së privatësisë që disponon institucioni i arsimit të lartë ofrohet mbrojtje e informacionit sensitiv nga palët e paautorizuara. Platforma elektronike lejon aksesin vetëm për personat e autorizuar dhe kontrollon aksesin në të dhëna sensitive për persona të paautorizuar. ⁶⁸ Në mënyrë periodike, UAMD kontrollon mbarëvajtjen e punës si dhe zbatimin me korrektësi të detyrave dhe kërkesave ligjore për menaxhimin e të dhënave të studentëve.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Këto kontrolle mund të organizohen në nivel njësie kryesore, në nivel institucional dhe në disa raste si audit i jashtëm nga MAS.

⁶⁶ <https://uamd.pitagora.rash.al>

⁶⁷ Evidenca 26. Te dhenat e studenteve AWDG

⁶⁸ Evidenca 5. Rregullore e UAMD neni 69 pika 8
Evidenca 6. Rregullore e FTI neni 53 pika 8

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Sipas rregullores së UAMD studentit ka përfaqësinë e vet në organet vendimmarrëse e këshilluese në përputhje dhe sipas të gjitha dispozitave ligjore. ⁶⁹
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për vlerësimin e procesit mësimor, infrastrukturës, lirinë e studentit për të ngritur dhe formuar organizime. Studentëve i garantohet liria dhe e drejta e përzgjedhjes së Drejtuesit të NJK dhe Rektorit të Universitetit. ⁷⁰
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për vlerësimin e procesit mësimor, infrastrukturës, lirinë e studentit për të ngritur dhe formuar organizime. Studentëve i garantohet liria dhe e drejta e përzgjedhjes së Drejtuesit të NJK dhe Rektorit të Universitetit.
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	FTI mer opinionin e studentëve në përfundim të çdo lënde si dhe ruan kontakte me studentët edhe pas diplomimit të tyre. Ndryshimi i kurrikulave si rregull për FTI realizohet në mënyrë periodike çdo 5-6 vite. Megjithatë opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve etj. Ndryshimet afatshkurtër në programin e studimit mund të reflektohen në programet e lëndëve.
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut	Të gjitha instancat e UAMD kanë në qendër studentin. Rregullorja e institucionit garanton të drejtën e studentit për të dhënë mendim në lidhje me procesin mësimor, lektorin, infrastrukturën. (<i>Evidenca 5 – Rregullore UAMD, Neni 115, pika 1, dh; Evidenca - 6, Rregullore FTI, Neni 87, 1. dh; Evidenca 8 - Rregullore e NJSBC Neni 6 pika a</i>) FTI ka një mënyrë plotësisht transparente dhe të unifikuar të vlerësimit dhe të ballafaqimit të rezultateve. Personeli akademik ka detyrim të

⁶⁹ Evidenca 5. Rregullore e UAMD Kreu VI
Evidenca 6. Rregullore e FTI kreu VI

⁷⁰ Evidenca 5. Rregullore e UAMD kreu VI
Evidenca 6. Rregullore e FTI kreu VI

përgjegjës.	ballafaqojë rezultatet me studentët 72 orë nga realizimi i testimit dhe të sqarojë çdo paqartësi të tyre në lidhje me vlerësimin e testimit. Në rast se edhe pas ballafaqimit të rezultateve studenti nuk është i bindur për vlerësimin, ai ka të drejtë të kërkojë rishikimin e tezës jo më vonë se 48 orë nga marja e rezultateve. Rishikimi i tezës realizohet nga një komision i ngritur nga njësia bazë që mbulon lëndën në prezencë të studentit dhe personelit akademik të kursit. Komisioni vendos për vlerësimin përfundimtar. (Evidenca - 6, Rregullore FTI, Neni 53 pika 7, Neni 56 pikat 1 dhe 6)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka ngritur në shërbim të tij, Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike e cila në përbërjen e saj ka Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Ky sektor është përgjegjës për shërbimin e informacionit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët por edhe me palë të tjera të interesuara. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë.
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës bën gjurmimin dhe ndjekjen e studentëve të diplomuar, mbledh të dhëna mbi punësimin e tyre dhe krijon Databazën Alumni me të dhënat mbi punueshmërinë. Databaza Alumni rifreskohet nga mbledhja e të dhënave pas dërgimit elektronikisht dhe plotësimit të formularit Alumni nga ish-studentët. Databaza i vihet në dispozicion organeve drejtuese të UAMD nëse kërkohet.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet Përmbushet

	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X
Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional
“Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik ” të Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Aleksander Moisiu Durres ”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Program që u përgigjet në kohë më të shpejtë kërkesave të tregut të punës
2. Studentët aftësohen në fushën e teknologjive web dhe dizenjimit grafik
3. Mundësi punësimi nga kompani shqiptare dhe të huaja
4. Ambjente të përshtatshme për praktikat mësimore

Pika të dobta

1. Nivel i ulët i studentëve në hyrje



Lista e dokumentacionit mbështetës të vetvlerësimit


Lista e mëposhtme është dokumentacion i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë; mundet që në një dokument mund të përmbliidhen disa nga të dhënat e kërkuara.

Në rastet kur dokumenti është ndryshuar totalisht ose pjesërisht, citimi i tij duhet të reflektojë edhe ndryshimet e bëra (ose të bashkëngjiten të dy dokumentet). Gjithashtu mund të përdoren evidenca të tjera që Institucioni ka në funksionin e tij.

Lista e dokumentave përmban **emërtimin e plotë të dokumentit** (psh statuti etj), ndërsa në Raport duhen cituar **edhe pjesët përkatëse të tij** (psh statuti i IAL, neni x, pika y).

Në rastin e mbështetjes / citimit në ligjet/aktet ligjore, këto dokumenta duhet të jenë pjesë e listës së mëposhtme (pjesërisht/ose plotësisht)

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i IAL (Pjesë për kriteret përkatëse);
3. Strategjia e zhvillimit të Institucionit;
4. Plani strategjik për zhvillimin e programit (në nivel akademik, financiar, burimesh njerëzore etj);
5. Rregullore e Institucionit të AL;
6. Rregullore e Njësisë Kryesore/bazë
7. Rregullore e programit të studimit;
8. Rregullore e NJSBC
9. Rregullore e Sekretarisë mësimore
10. Rregullore e diplomimit;
11. Rregullore e zyrës së Burimeve njerëzore;
12. Rregullore e zyrës/njësisë së këshillimit dhe karrierës;
13. Rregullore e zyrës /njësisë së monitorimit të Kurrikulës;
14. Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij
15. Modeli i diplomës (Urdhëri i aprovimit); Modeli i Suplementit të Diplomës;
16. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit (dokument i procesit të hapjes);
17. Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve;
18. Plotësimi i rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe/ose akreditimi i mëparshëm;
19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite;
20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit).
22. CV e stafit ndihmës akademik



23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit)
25. Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha programet e studimit;
26. Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse
27. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje
28. Të dhëna Tabelore përmbledhëse për transferimet e studimeve nga studentët prej ... dhe nga ...;
29. Të dhëna Tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve
30. Të dhëna tabelore për: njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë;
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane;
32. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale;
33. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale të mëtejshme, për studentët e diplomuar;
34. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj dhe për praktikën profesionale;
35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;
36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit;
37. Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë;
38. Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional;
39. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve;
40. Pyetëtori i studentëve
41. Pyetëtori i stafit akademik dhe ndihmës akademik;
42. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (sallat/ laboratorët/ studiot/ atelietë/ platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online); hapësirat ndihmëse; raporti ekspertit për infrastrukturën;
43. Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit;
44. Formati i Dosjes personale të stafit

45. Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit;
46. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit;
47. Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB (për kriteret përkatëse);
48. Politikat institucionale të publikimit të informacionit (Udhëzues të posaçëm; takime të hapura; faqja e IAL në web; etj)
49. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit; plani për mbështetje financiare për një cikël të plotë studimi;
50. Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit (Tabelë përmbledhëse);
51. Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun;
52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (nëse ka patur);

A series of handwritten signatures in blue ink, including a large stylized signature on the left and several smaller ones to the right.